
PLANPROGRAMI TRE VJEÇAR I SPECIALIZIMIT NGA ORTOPEDIA E NOFULLAVE

HYRJE

Planprogrami i ri tre vjeçar për edukim nga lëmia e Ortopedisë së Nofullave ka për qëllim aftësimin profesional që të përmirsojë cilësinë e edukimit specialistik.

Ortopedia e Nofullave si lëmi preventive dhe kurative e stomatologjisë duhet të sigurojë një trajtim të volitshëm të anomalive të sistemit orofacial, e ky trajtim duhet të bëhet nga specialistët e arsimuar mirë.

Secili specializant duhet të trajtoj së paku pesëdhjetë (40) pacientë me dokumentacion të plotë.

Planprogrami thelbësor i specializimit parasheh që së paku 75% të kohës së specializimit t'i kushtohet lëndës së Ortopedisë së Nofullave, e deri në 25% lëndëve plotëesuese.

Numri minimal i orëve për trajtim klinik duhet të jetë gjashtëmbëdhjetë (16) orë në javë (pa u përfshirë ligjeratat, seminarët klinike, kolokviumet dhe diskutimet për planet e trajtimit, dhe puna në laborator).

Përpjestimi klinik për mbikëqyrje duhet të jetë: një pedagog universitar : dy (2) specializantë.

QËLLIMI I PROGRAMIT PËR EDUKIM SPECIALISTIK

Planprogrami i specializimit është i përpiluar në atë mënyrë që ta definojë qartë qëllimin dhe kërkesat që stomatologët të arsimohen për t'u bërë specialist të Ortopedisë së Nofullave. Ky kuadër i kualifikuar, duhet të sigurojë shërbim të mirë bashkëkohor, që të përmirësohet morfologjia, funksioni dhe estetika e këtij regjioni në suaza të optimumit individual.

KUSHTET SPECIFIKE PËR EDUKIM SPECIALISTIK

Specializimi për këtë lëndë duhet të bëhet në institucionet gjegjëse që i përmbushin kushtet e domosdoshme siç janë: hapësira punuese, pajisjet medicinale-teknike, dhe realizimi i aktiviteteve profesionale.

Mbikëqyrësi i specializimit duhet të jetë Specialist i Ortopedisë së Nofullave i cili më së paku tre (3) vjet ushtron aktivisht këtë lëmi. Programin mësimor teorik dhe praktik e udhëheq kuadri akademik. Specializanti duhet të ketë çasje në bibliotekë, laborator dhe klinikë, ku i ofrohen edhe mundësitë për punë hulumtuese.

Gjatë stazhit specialistik parashihen këto veprimtari:

- **puna praktike klinike;**
- **konsultimet rreth trajtimit;**
- **seminaret për vlerësim të trajtimit;**
- **ligjeratat, seminarët, kolokviumet dhe mbledhjet e punës.**

KOHA E SPECIALIZIMIT DHE VEPRIMTARITË E DUHURA

Specializimi nga Ortopedia e Nofullave zgjatë tridhjetëegjastë (36) muaj.

Mësimi teorik dysemestral është i obliguar.

Në kuadër të specializimit duhet të kryhet edhe stazhi specialistik nga këto degë të Stomatologjisë:

- Ortodoncia	28 muaj
- Kirurgjia maksilofaciale	2 muaj
- Kirurgjia orale	1 muaj
- Pedodoncia dhe Stomatologjia Preventive	2 muaj
- Pushimi vjetor	3 muaj

Çdo vjet, specializantit i takon nga një muaj pushim vjetor.

1. PROGRAMI I SPECIALIZIMIT

- Njohuritë teorike

Gjatë mësimi teorik dy semestral duhet të përfshihet kryesisht lënda e Ortopedisë së Nofullave si dhe kapituj të zgjedhur nga Kirurgjia maksilofaciale, Kirurgjia orale dhe Pedodoncia dhe Stomatologjia preventive.

Ligjeratat duhet të organizohen nga një orë në ditë, ndërsa kohën tjetër duhet t'ia kushtojnë mësimi praktik.

ORTOPEDIA E NOFULLAVE

- Rritja dhe zhvillimi i sistemit kraniofacial, prenatal dhe postnatal
- Anatomia dhe morfologjia e viscerokraniumit,
- Biologjia e qelizës me bazat e gjenetikës humane,
- Fiziologjia e funksioneve të sistemit orofacial,
- Sindromet që përfshijnë edhe sistemin kraniofacial,
- Zhvillimi i dentionit dhe okluzionit normal,
- Anomalitë dentoalveolare dhe gnatike të sistemit orofacial,
- Faktorët etiologjik të anomalive ortodontike,
- Radiologjia speciale dhe cefalometrike,
- Metodat e diagnostikimit në ortodonci, vlerësimi dhe planifikimi i trajtimit,
- Teknikat ortodontike të trajtimit (aparartet mobile, funksionale, fikse, ekstraorale dhe aparatet e retencionit),
- Ortodoncia preventive dhe interceptive,
- Ortodoncia adulte,
- Biomekanika e spostimit ortodontik të dhëmbit me indet tjera të sistemit orofacial; reacionet e indeve të forta dhe të buta.
- Retencionit dhe recidivet
- Pasojat e anomalive ortodontike,

- Përcjellja dhe epidemiologjia e anomalive ortodontike

Pasi të kryhet mësimi teorik dysemestral nga kandidatët kërkohet që të verifikohen njohuritë teorike (ipet kolokviumi).

KIRURGJIA MAKSILOFACIALE DHE ORALE

- Problematika kirurgjike e lidhur me trajtimin ortodontik
- Dhëmbët e retinuar dhe të impaktuar, dhëmbët e tepërt, hipetrofia e frenulumit të buzës së epërme dhe frenulumi linguae breve,
- Aspekti kirurgjiko-ortodontik i traumave të regjionit kraniofacial,
- Trajtimi kirurgjiko-ortodontik i anomalive orofaciale skeletore dhe atyre të lindura.

PEDODONCIA DHE STOMATOLOGJIA PREVENTIVE

- Diagnoza, indikacionet dhe terapia e sëmundjeve të dhëmbëve te fëmijët
- Epidemiologjia e kariesit dentar
- Parandalimi i kariesit dentar
- Aspektet pedodontike të traumave të dhëmbëve
- Sanimi protetik i fëmijëve
- Puna me fëmijë të hendikepuar
- Organizimi i shërbimit për parandalimin e sëmundjeve të gojës dhe të dhëmbëve te fëmijët

PUNA PRAKTIKE ME SPECIALIZANTË

Ortopedia e nofullave

Specializanti për punë praktike në lëminë e Ortodoncisë duhet të aftësohet që të:

1. zbulojë me kohë anomalitë e sistemit orofacial;
2. t'i diagnostikojë këto anomali;
3. t'i vlerësojë këto anomali nga aspekti morfologjik e funksional;
4. ta vlerësoj nevojën për trajtim dhe kohën kur duhet të bëhet trajtimi i tyre;
5. ta përcaktoj etiologjinë e anomalive të sistemit orofacial;
6. ta bëjë analizën e filmave të rendgenit (intra dhe ekstra oral);
7. ta bëjë planin e terapisë dhe ta përcaktojë rrjedhën e mjekimit;
8. t'i aprovojë metodat e thjeshta dhe ato të komplikuar të mjekimit ortodontik;
9. të aplikojë metodat e ndryshme të trajtimit me aparate intraorale, ekstraorale, intra dhe ekstraorale: mobile (aktive dhe aktivatorë) dhe aparate fikse;
10. të zgjedhë aparatet adekuat ortodontik për trajtim;
11. të vlerësoj me saktësi prognozën e mjekimit ortodontik;
12. t'i vlerësoj aspektet psikike relevante me këto anomali;
13. të merr pjesë në ekipin për mjekimin e deformiteteve të rënda të nofullave;
14. ta bëjë trajtimin ortodontik të fëmijëve me të meta në zhvillim;
15. të udhëheq mirë dhe me kohë masat preventive dhe interceptive ortodontike;

16. të ushtrroj profesionin e ortodontit me standarde më të larta profesionale dhe etike.

Përkujdesja ndaj pacientit duhet me qenë e cilësisë së lartë.

KATALOGU I PUNIMEVE

Gjatë stazhit specialistik duhet të trajtohen anomalitë në vijim:

1. Anomalitë e dhëmbëve në veçanti (rotacioni, inklinimi, ektopia, transpozicioni)	6 raste
2. Anomalitë e numrit të dhëmbëve (hiperdoncioni, hipodoncioni)	4 raste
3. Dendësitë (primare, sekondare, e përzier)	6 raste
4. Diastema mediane	2 raste
5. Kafshimi i kundërt i incizivëve	2 raste
6. Anomalitë e okluzionit:	
a. Në rrafshin sagjital:	
i. Malokluzionet e kl. II/1	3 raste
ii. Malokluzionet e kl. II/2	2 raste
iii. Malokluzionet e kl. III	2 raste
b. Në rrafshin transversal	
Kafshimi i kryqëzuar	2 raste
c. në rrafshin vertikal	
i. kafshimi i hapur	1 rast
ii. kafshimi i thellë	1 rast
7. Rastet me ekstraksion të dhëmbëve	5 raste
8. Dekortikimi selektiv	1 rast
9. Rastet me trauma	1 rast
10. Puna në ekip për trajtimin e malokluzioneve	2 raste

KIRURGJIA MAKSILLOFACIALE

Gjatë stazhit specialistik në Kirurgjinë Maksillofaciale specialisti duhet të njohtohet me mënyrat e mjekimit kirurgjikal të deformiteteve të rënda të nofullave dhe fytyrës siç janë:

- anomalitë skeletore të Kl. II
- anomalitë skeletore të Kl. III
- kafshimi i hapur skeletor

- asimetritë e fytyrës (ankiloza e nyjes temporomandibulare)
- çarjet e ndryshme të sistemit orofacial.

KIRURGJIA ORALE

Gjatë stazhit specialistik nga Kirurgjia Orale specializanti njohtohet me mjekim kirurgjikal të dhëmbëve të tepërt, të dhëmbëve të impaktuar, me zhermektomitë e molarëve të tretë, me frenektomi dhe intervenime të tjera nga kjo lëmi.

PEDODONCIA DHE STOMATOLOGJIA PREVENTIVE

Gjatë stazhit specialistik nga Pedodoncia dhe Stomatologjia preventive, kandidati aftësohet për punë vetanake për zgjidhjen diagnostike dhe terapeutike të problemit të humbjes së hapësirës për dhëmbë, si pasojë e humbjes së hershme të dhëmbëve të qumështit dhe atyre të përhershëm. Mësohet që ti bëjë mbushjet me sipërfaqe aproksimale që e sigurojnë pikën kontaktuese për ta penguar humbjen e hapësirës për shkak të kariesit aproksimal. Aftësohet për mbarimin dhe aplikimin e ruajtësve mobil dhe fiks të hapësirës.

VERIFIKIMI I AFTËSIMIT PROFESIONAL TË KANDIDATIT

Gjatë stazhit specialistik, mentori me mbikëqyrje të përhershme i verifikon njohuritë dhe dituritë e fituara, suksesin e mjekimit të anomalive të ndryshme ortodontike, duke filluar nga ato më të lehtat deri te anomalitë më të rënda kongjenitale të regjionit orofacial. Këtu hyjnë edhe pacientët me sindrome të cilat manifestohen me ndryshime patologjike të këtij regjioni.

Niveli i dijes verifikohet me kolokviume të kryera lidhur me njësitë e veçanta mësimore. Po ashtu kërkohet që specializanti të jetë pjesëmarrës i tubimeve profesionale. Është e dëshirueshme që edhe ai vet të jetë prezentues i punimeve profesionale.

PËRFUNDIMI I SPECIALIZIMIT

Kushtet për kryerjen e specializimit:

- Planprogrami i paraparë i stazhit specialistik i kryer me sukses,
- Kolokviumet nga lënda bazë dhe lëndët e tjera të zgjedhura (turnuset) të dhëna me sukses,
- Kurset dhe seminarët të vlerësohen pozitivisht,
- Specializanti duhet t'i prezentojë të dhënat dhe rezultatet e kompletuara dhe të dokumentuara nga 10 pacientë të trajtuar me anomali të ndryshme ortodontike,
- Provimi përfundimtarë praktik dhe teorik ipet para komisionit tre anëtarësh, i cili e bënë vlerësimin profesional të kandidatit.